



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR

Nr. _____ Prot

Shkodër, më _____.____.2023

PROCESVERBAL - Tipi i kontratës - Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

**OBJEKTI I PROCEDURËS: Hartimi i studimeve të fizibilitetit, planeve zhvillimore ,
masterplane , projekt-ide teknike dhe projekteve teknike të ndryshme të detajuara**

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT

(Kodi CPV: 22114311-5 - Projekte, 71220000-6 - Shërbime për projektim të arkitektures, 71221000-3 - Shërbim për projektim ndërtesash, 71400000-2 - Shërbime të planifikimit urban dhe planifikimeve piktoreske, 71410000-5 - Shërbimet e planifikimit urban

VLERA E FONDIT LIMIT:

Vlera e pritshme e kontratës/kontratave është **50,000,000** (pesdhjetemilion) leke **pa TVSH** ose **480,261**(Katerqind e tetëdhjetemije e dyqind e gjashtëdhjete e një) Euro. Kursi i këmbimit **104.11 Lekë/Euro**

Kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë në datën 14.11.2023 është 104.11 Lekë/Euro

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Shkoder**, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. *Formulari i ofertes sipas Shtojce 3 (do te kerkohet gjate fazes se dyte te minikonkurimit).*
- b. *Lista e Çmimeve të Shërbimeve sipas Shtojce 4 (do te kerkohet gjate fazes se dyte te minikonkurimit)*
- c. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 11;*
- d. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 5 (do te kerkohet gjate fazes se dyte te minikonkurimit).*
- e. *Vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit, këto dokumente do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit).*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Kriteret e mesiperme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertes”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik: citojme Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashke me dorezimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prove paraprake në vend të disa vërtetimeve të leshuara nga autoritetet publike ose pale të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”

Kërkesa e gjurmës “e” për disponim të dokumentit “Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri” vendoset sipas përcaktimeve të nenit 26, pika 7, gjurma “c” të VKM-së Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar) ku citohet se: “Një vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri. Mosshlyerja e detyrimeve të energjisë elektrike përbën shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik, përveç rastit kur rezulton se detyrimet e papaguara të energjisë elektrike, të konfirmuara në vërtetimin e lëshuar nga furnizuesi, janë në proces ankimi në gjykatë. Furnizuesi i energjisë elektrike është i detyruar që ta lëshojë këtë vërtetim jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e depozitimit të kërkesës nga operatori ekonomik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Sipas pikës 1 të shtojcës 11 (Kriteret e Përgjithshme për Kualifikim).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2020, 2021, 2022, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit e konkretisht **20,000,000** (Njzetmilion) lekë.

Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, pra 40% e vlerës së fondit limit, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Lloji i procedure është " e kufizuar mbi kufirin e lartë monetar", përcaktimi i vlerës së kërkuar është bërë në mbështetje të nenin 43, pika 2, germa "a" të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar ku përcaktohet se: " dyfishin e vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit¹, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar si dhe në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", si dhe në Udhëzimin e Ministrisë të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar është bërë në mbështetje të nenin 43, pika 1 " të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" ku përcaktohet se: " Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rasti të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare".

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2020, 2021 dhe 2022, të certifikuara nga autoritetet përkatëse (Dega e Tatim Taksave) ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit

¹ Ndryshuar me Vendimin Nr. 710 datë 24.11.2021

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

2.2.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një dokument që vërteton se ka paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore për të gjitha vendet ku operatori ka ushtruar aktivitetet për vitin 2023 (Sipas QKB) sipas përcaktimeve në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore për vitin 2023.

Kriteri konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 11të DT. Dokumentet e kërkuar më sipër do të paraqitet përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohe sqarime nga autoriteti kontraktor.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë se ka paguar detyrimet e taksave vendore për vitin 2023, të parashikuara në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të DST-së objekt prokurimi.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar në nenin 77, pika 3, e LPP, nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe ligjin nr.9920 date 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2, gërma d) dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Ky kriter shërben për të garantuar AK se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, kanë kapacitetet e duhura ekonomike dhe financiare si dhe janë të përshtatshëm për të kryer veprimtari profesionale. Referuar sa më sipër, Autoriteti Kontraktor gjykon se kriteri i vendosur lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të deklaratës për shlyerjen e detyrimeve vendore për vitin 2023, pranë bashkisë/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin

e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për“Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari Biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për t’iu nënshtuar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

Shënim: Operoret ekonomik te kualifikuar te fazes se pare (lista e shkurtër), duhet te dorezojnë pranë AK, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet te paraqitur në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e njoftimit te kontrates, në një vlerë jo më të vogël se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe konkretisht **20,000,000** (Njzetmilion) lekë.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) Për përvojën e mëparshme të realizuar me ente publike, Operatori ekonomik duhet të paraqesë Kontratën e nënshkruar me entin, të shoqëruar me vërtetimin e lëshuar nga Enti Publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera dhe afati i përfundimit të kontratës.
- b) Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

1.1 Per kontratat e realizuara si Bashkim Operatoresh, operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë: Kontraten e bashkimit te operatoreve dhe prokuren e posacme te deklaruara ne fazen e tenderimit.

1.2 Per kontratat e realizuara si Nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë: Kontratën baze ndermjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor si dhe Miratimi zyrtar si nenkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe në nenin 41 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët

ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40% e të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.

Vlera e parashikuar e kontrates është mbi kufirin e lartë monetar. Vlera jo më e vogël se 40 % e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet, përben një nivel të mjaftueshëm përvojë duke patur parasysh objektin dhe vlerën e kontrates.

Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garantojnë autoritetin, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së shërbimeve të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie.

Shihet e arsyeshme që OE të përfshijë kategoritë në fushat e studimit dhe projektimit në ndërtim si më poshtë vijon

2.3.2 Licënsa profesionale të operatorit ekonomik (e vlefshme) për projektim (lëshuar nga MZHUT ose nga Institucioni i Autorizuar sipas legjislacionit në fuqi për dhënien e licensave profesionale në fushën e studimit e projektimit në ndërtim), ku të përfshihen kategoritë:

1. PROJEKTUES URBANIST

b)2.Plane sektoriale në nivel bashkie

2. PROJEKTUES ARKITEKT

a)Projektim arkitekturor për objekte banimi-objekte industriale-objekte turistike

b)1.Objekte sportive të mbuluara ose pjesërisht të mbuluara 2.qendra tregtare,objekte sociale kulturore..

d) Projektim peisazhi,sistemim sipërfaqe të gjelbërta, lulishte e parqe.

3. PROJEKTUES KONSTRUKTOR

a)Objekte civile-industriale-turistike prej murature e skelet/beton...

b-1Objekte civile-industriale-turistike mbi 5 kate

4.PROJEKTUES INSTALATOR

i- Projektimi i ndriçimit rrugor, shesheve, dekorativ,

5. PROJEKTUES VEPRA HIDRAULIKE

b) Projektim furnizim me ujë – kolektorë shkarkimi.

c)Ujësjiellës kanalizime urbane- rurale.

6. PROJEKTUES RRUGË-HEKURUDHA

a) Projektim rrugë lokale, rrugë urbane dytësore dhe rrugë interurbane dytësore.

b- Projektim rrugë urbane kryesore dhe rrugë interurbane kryesore.

10.PROJEKTIMI I IMPIANTËVE TË PRODHIMIT DHE SHPËRNDARJES SË ENERGISË ELEKTRIKE

e) Projektim kabina elektrike të rrjetit shpërndarës – linja të tensionit të ulët – të mesëm.

11. PROJEKTUES TË SINJALIZIMIT RRUGOR

a) Projektim sinjalistike jondricuese në rrugë lokale, rrugë urbane dytësore, rrugë interurbane dytësore, sheshe e parkime

b- Sinjalistikë jondricuese në autostrada, rrugë urbane kryesore dhe rrugë interurbane kryesore dhe në degëzime me hekurudhën.

d) Projektim sinjalistike ndricuese në infrastrukture.

(Për Operatorët e huaj të bëhet njehsimi i licencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë institucionit përkatës, në plotësim të licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës).

*Sqarim: Për licencat e lëshuara pas hyrjes në fuqi të Vendimit nr.943, datë 28.12.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.759, datë 12.11.2014, të Këshillit të Ministrave ‘Për licencimin profesional të individëve dhe personave juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e kolaudit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë **Liçensa profesionale të shoqërisë (e vlefshme) për projektim (leshuar nga MZHUT** ose institucione të tjera të autorizuara sipas legjislacionit në fuqi për dhënien e licensave profesionale në fushën e studim projektimit në ndërtim), e vlefshme, ku të përfshihen kategoritë e mësipërme me ndryshimet përkatëse në emërtesë.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe vendimin nr.759, datë 12.11.2014 të Këshillit të Ministrave, “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e koaludimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, ndryshuar me VKM-në nr.943 datë 28.12.2016” (shënim- përcaktoni aktin ligjor ose nënligjor specifik dhe nenin përkatës, që parashikon licencimin e subjekteve, në lidhje me veprimtarinë përkatëse për realizimin e shërbimeve objekt kontrate).

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente. Licensat e mësipërme janë vendosur në kuadër të natyrës së përgjithshme të punimeve që priten të realizohen në këtë procedurë.

Vlerësojmë që operatorët ekonomikë duhet të zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm dhe të pranueshëm cilësie.

Më konkretisht, po paraqesim argumentimet si më poshtë:

<i>KATEGORIA E KËRKUAR</i>	<i>PËRSHKRIMI I KATEGORISË</i>	<i>ARGUMENTIMI</i>
PROJEKTUES URBANIST 1.b)2.	Plane sektoriale ne nivel bashkie	Bazuar në termat e referencës, gjykohet që kjo pikë është e nevojshme për realizimin me sukses të shërbimeve të kërkuara, sepse projektuesi bazuar në legjislacionin në fuqi dhe në Planin e Përgjithshëm Vendor të miratuar në KKT me Vendim nr. 5 me datë 16/10/2017, Dokumentit të rishikimit të Planit të Përgjithshëm Vendor miratuar me vendim Nr. 9 datë 28.12.2020, të KKT, do të hartohen, rishikohen dhe detajohen me tej disa nga Planet e Detajuara Vendore,
PROJEKTUES ARKITEKT 2. a)	Projektimarkitekturor per objekte banimi-objekte industriale-objekte turistike	Bazuar në termat e referencës, gjykohet që kjo pikë është e nevojshme për realizimin me sukses të shërbimeve të kërkuara, sepse projektuesi do te trajtoje ne fazen e projektit objekte banimi pallate muze, objekte industriale etj
PROJEKTUES ARKITEKT	Objekte sportive te mbuluara ose	Bazuar në termat e referencës, gjykohet që kjo pikë është e nevojshme për realizimin me sukses të

2.b)1.Objektesportive te mbuluara ose pjesisht tembuluara	pjeserisht te mbuluara	shërbimeve të kërkuara, sepse projektuesi do te trajtoje fusha sportive te reja dhe egzistuese, pallate sporti dhe ambiente te ndryshme sportive.
PROJEKTUES ARKITEKT 2.b)2	qendra tregtare,objekte social kulturore	Duke ju referuar Termave te References projektuesi do te trajtoje objekte arsimore shkolla te profileve te ndryshme, galeri arti etj per te cilen nevojitet projektuesi arkitekt me kategorine perkatese.
PROJEKTUES ARKITEKT 2 – d	Projektim peisazhi, sistemim sipërfaqe të gjelbërta, lulishte e parqe.	Bazuar në termat e referencës, gjykohet që kjo pikë është e nevojshme për realizimin me sukses të shërbimeve të kërkuara, sepse projektuesi do te trajtoje ne fazen e projekt te gjitha hapsirat e lira urbane si blloqe banimi,lulishte etj
PROJEKTUES KONSTRUKTOR 3.a)	Objekte civile-industriale-turistike prej murature e skelet/beton	Duke ju referuar Termave te References , Objektet te cilat priten te konceptohen ne kete projekt do te jete struktura prej murature e skelet/beton per te cilat nevojitet projektuesi konstruktor me kategorine perkatese
PROJEKTUES KONSTRUKTOR 3.b-1	Objekte civile-industriale-turistike mbi 5 kate	Duke ju referuar Termave te References , Objektet te cilat priten te konceptohen ne kete projekt do te jete struktura me lartesi maksimale deri ne 6 kate me strukture me skelet b/a antisizmike, per te cilat nevojitet projektuesi konstruktor me kategorine perkatese
PROJEKTUES INSTALATOR 4-i	Projektimi i ndriçimit rrugor, shesheve, dekorativ	Bazuar në termat e referencës, gjykohet që kjo pikë është e nevojshme për realizimin me sukses të shërbimeve të kërkuara, sepse projektuesi do te hartoje edhe projektin e ndricimit rrugor dhe blloqeve te pallateve etj
PROJEKTUES VEPRÄ HIDRAULIKE 5-b	Projektim furnizim me ujë – kolektorë shkarkimi.	Bazuar në termat e referencës, meqënëse kemi të parashikuar infrastrukture të brendëshme rrugore, si rrjedhojë gjykohet që kjo pikë është e nevojshme për realizimin me sukses të shërbimeve të kërkuara. te kete sistemet e furnizimit me uje dhe te shkarkimit, per projektimin e se cilit nevojitet projektuesi Instalator me kategorine perkatese

PROJEKTUES VEPRA HIDRAULIKE 5-c	Projektim Ujësjiellës kanalizime urbane-rurale	Bazuar në termat e referencës, gjykohet që kjo pikë është e nevojshme për realizimin me sukses të shërbimeve të kërkuara.
PROJEKTUES RRUGË-HEKURUDHA 6 - a	Projektimi rrugë lokale, rrugë urbane dytësore dhe rrugë interurbane kryesore	Bazuar në termat e referencës, parashikohet realizimi i rrugëve rurale apo urbane, dytësore dhe aksesit të tij me sistemin ekzistues rrugor, si rrjedhojë gjykohet që kjo pikë është e nevojshme për realizimin me sukses të shërbimeve të kërkuara.
PROJEKTUES RRUGË-HEKURUDHA 6-b	Projektim rruge urbane kryesore dhe rrugë interurbane kryesore	Bazuar në termat e referencës, parashikohet realizimi i rrugëve kryesore dhe rruge interurbane kryesore dhe aksesit të tij me sistemin ekzistues rrugor, si rrjedhojë gjykohet që kjo pikë është e nevojshme për realizimin me sukses të shërbimeve të kërkuara.
PROJEKTIMI I IMPIANTËVE TË PRODHIMIT DHE SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE 10 – e	Projektim kabina elektrike të rjetit shpërndarës – linja të tensionit të ulët – të mesëm.	Bazuar në termat e referencës , ndricimi rrugor, furnizim ky i cili do të sigurohet nga realizimi i kabinave elektrike me linja të tensionit të ulët dhe të mesëm për furnizim, si rrjedhojë gjykohet që kjo pikë është e nevojshme për realizimin me sukses të shërbimeve të kërkuara.
PROJEKTUES TË SINJALIZIMIT RRUGOR 11 – a	Projektim sinjalistike jo ndricuese, në rrugë lokale, rruge urbane dytësore, rrugë interurbane dytësore, sheshe dhe parkime.	Bazuar në termat e referencës parashikohet realizimi i rrugëve dhe shesheve të brendshme është e nevojshme parashikimi i realizimit të sinjalistikës jo ndricuese, tabela dhe vijezim horizontal si pjesë integrale e projekteve të infrastruktures rrugore e jo vetëm, si rrjedhojë gjykohet që kjo pikë është e nevojshme për realizimin me sukses të shërbimeve të kërkuara.
PROJEKTUES TË SINJALIZIMIT RRUGOR 11-b	Sinjalistikë jondricuese në autostrada, rrugë urbane kryesore dhe rrugë interurbane kryesore dhe në degëzime me hekurudhën	Bazuar në termat e referencës, parashikohet realizimi i parashikimi i realizimit të sinjalistikës jo ndricuese, tabela dhe vijezim horizontal si pjesë integrale e projekteve të infrastruktures rrugore e jo vetëm, si rrjedhojë gjykohet që kjo pikë është e nevojshme për realizimin me sukses të shërbimeve të kërkuara.
PROJEKTUES TË SINJALIZIMIT	Projektim Sinjalistike Ndricuese në	Bazuar në termat e referencës, përfshihet edhe pajisja me sinjalistike rrugore ndricuese, drita

RRUGOR 11 – d	Infrastrukturë.	pulsuese etj, si rrjedhojë gjykohet që kjo pikë është e nevojshme për realizimin me sukses të shërbimeve të kërkuara.
----------------------	-----------------	---

2.3.3 Operatori Ekonomik duhet të ketë si drejtues teknik stafin si më poshtë dhe të jenë të përfshirë në listpagesën e shoqërisë për muajin e fundit të deklaruar:

- 1(nje) Urbanist;
- 1 (nje) Arkitekt;
- 1 (nje) Inxhinier Ndertimi/1 (nje) Inxhinier Hidroteknik;
- 1 (nje) Inxhinier Elektrik;
- 1 (një) Ekspert Mjedisi

Per stafin e mesiperm Operatori Ekonomik duhet të paraqese:

Kontratat individuale te punes (të vlefshme), Licencat profesionale, Diplomë .

Shënim: Sqarojmë se në përmbushjen e kriterit të sipërcituar, operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës nr.12, ku të deklarohet disponimi i punonjësit të sipërcituar.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Shënim: Operatoret ekonomik te kualifikuar te fazes se pare (lista e shkurtër), duhet te dorezojnë pranë AK, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet te paraqitur në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

- *Një projektues/inxhinier nuk duhet të jetë i angazhuar njëkohësisht në stafin e dy shoqërive që marrin pjesë në procedurën e prokurimit(deklarate nga projektuesi).*
- *Stafi i angazhuar (projektues/inxhinier) duhet të paraqesë nje deklaratë te disponueshmërise për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë*

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të

kontratës. Njësia e prokurimit për vendosjen e stafit i është referuar Termave të përgjithshme të references për objektet pjesë e kësaj procedure, pjesë e secilave do të jenë të licensuar për shërbimet që priten të realizohen.

- Punimet për shërbimin e projekteve strukturore kanë gjithashtu një volum të rëndësishëm, pasi kryesisht parashikohet të kemi realizim të objekteve me shkallë të ndryshme vështirësie të cilat kërkojnë gjykim dhe punime të specializuara në fushën e projektimit strukturor për të cilën kërkohej dhe staf ndihmes. Inxhinieri i ndërtimit do të duhet dhe në projektimin e nderhyrjeve të reja si rrjedhojë gjykohej që duhet të paktën **1 (një) inxhinier ndërtimi/1 (një) inxhinieri hidroteknik**, pjesë e stafit teknik.
- Shërbimet për projektimin arkitektonik priten të kenë një volumin të moderuar të projekteve që realizohen për nivelin e objekteve dhe realizimit të peizazhit subjekt i kësaj procedure, si objekte të një kategorie të vecante për të cilën gjykohej si e nevojshme prezenca e të paktën **1 (një) Arkitekti** si staf teknik (arkitekte godinash, peizazhi, etj).
- Punimet për shërbimin e projektimit të sistemeve elektrike parashikohen bazuar në termat e references, si rrjedhojë gjykohej si e nevojshme prezenca e të paktën **1 (një) inxhinieri elektrik**, si pjesë e stafit teknik.
- **Urbanisti** gjykohej i nevojshëm pasi sipas termave të references parashikohet që do të hartohen, rishikohen dhe detajohen me tej disa nga Planet e Detajuara Vendore,

2.3.4 Operatori Ekonomik ofertues duhet të ketë si staf mbështetës si më poshtë:

- 1 (një) Inxhinier Ndërtimi
- 1 (një) Ekspert Zjarrëfikës;
- 1 (një) Ekspert Mjedisi të pajisur me certificate lëshuar nga Ministria e Mjedisit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis.

Për punonjësit e mesipër Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

Kontratat individuale të punës (të vlefshme), Diplomë, Certifikata, CV

Shënim: Sqarojmë se në përmbushjen e kriterit të sipërcituar, operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës nr.11, ku të deklarohej disponimi i punonjësit të sipërcituar.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Shënim: Operatorët ekonomik të kualifikuar të fazës së parë (lista e shkurtër), duhet të dorëzojnë pranë AK, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet të paraqitura në formularin

përmbledhës të vetëdeklarimit si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

- *Një projektues/inxhinier nuk duhet të jetë i angazhuar njëkohësisht në stafin e dy shoqërive që marrin pjesë në procedurën e prokurimit(deklarate nga projektuesi).*
- *Stafi i angazhuar (projektues/inxhinier) duhet të paraqesë një deklaratë të disponueshmërisë për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë*

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Njesia e prokurimit për vendosjen e stafit i është referuar Termave të referencës, natyres së përgjithshme të shërbimeve që priten të ofrohen. Meqenëse kemi të bëjmë me rikonstrukcione rrugesh,blloqe banimi, rishikim i PDV prezenca e stafit të mesipër është gjykuar si e domosdoshme dhe e nevojshme për një shpërndarje dhe efikasitet sa më të madh në realizimin e shërbimeve konkretisht;

- Punimet për shërbimin e projekteve strukturore kanë gjithashtu një volum të rëndësishëm, pasi kryesisht parashikohet të kemi realizim të objekteve me shkallë të ndryshme vështiresie të cilat kërkojnë gjykim dhe punime të specializuara në fushën e projektimit strukturor për të cilën kërkohet dhe staf ndihmes. Inxhinieri i profilit Strukturist do të duhet dhe në projektimin e nderhyrjeve të reja si rrjedhojë gjykohet që duhet të paktën **1 (një) inxhinier ndertimi**, pjesë e stafit ndihmes.
- **Eksperti zjarrefikes** është i domosdoshëm të jetë prezent gjatë hartimit të projekteve të mbrojtjes ndaj zjarrit dhe vlerësimeve përkatëse të fushës bazuar në termat e referencës
- **1 (një) punonjës të pajisur me certificate lëshuar nga Ministria e Mjedisit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis**, gjykohet si i domosdoshëm për realizimin e VNM (Vlerësimet e ndikimit në Mjedis) për projektet që do të realizohen

2.3.5 Operatori Ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij të paktën 10 (dhjetë) punonjës për muajin fundit të deklaruar, të vërtetuar me:

- a) Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për periudhën e fundit të deklaruar.
- b) Listpagesat e punonjësve të konfirmuara nga autoritetet përkatëse sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën e fundit të deklaruar.
-
- **Shënim:** Sqarojmë se në përmbushjen e kriterit të sipërcituar, operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës nr.11, ku të deklarohet disponimi i punonjësve të sipërcituar.

- Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.
- **Shënim:** Operatorët ekonomik të kualifikuar të fazes së parë (lista e shkurtër), duhet të dorëzojnë pranë AK, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet të paraqitura në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Numri i përcaktuar i punonjësve është përlllogaritur si më poshtë: për përcaktimin e fuqisë punëtore minimale të kërkuar argumentojmë se jemi bazuar në shërbimet e kërkuara sipas Termave të References. *Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë, tregon besueshmëri për autoritetin. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë çdo dëshmi me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve dhe përvojën e tyre, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Numri i mesiper perkon me stafin që pritet të jete I angazhuar në keto procedura.*

Shënim: Operatorët ekonomik të kualifikuar të fazes së parë (lista e shkurtër), duhet të dorëzojnë pranë AK, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet të paraqitura në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

- Operatori ekonomik ofertues në përlllogaritjen e ofertës (**Faza II, Minikonkursi**), duhet ti referohet njoftimit të bërë me Nr. 5585 Prot. datë 25.07.2017 të Agjensisë së Prokurimit Publik ”Rekomandim mbi mënyrën e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.354 datë 11.05.2016 ”Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”.

Mospërgatitja e ofertës sipas bazës ligjore të sipërpërmendur përbën shkak për skualifikim pasi ajo duhet të jete brenda kufijve të vlerës minimale dhe maksimale të lejuar në kuptim të nenit 7/1 të VKM nr 354, datë 11.05.2016 "Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikimin të territorit, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim".

Eshte vendosur kjo kerkese bazuar ne njoftimin me Nr. 5585 Prot. datë 25.07.2017 të Agjensisë së Prokurimit Publik "Rekomandim mbi mënyrën e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.354 datë 11.05.2016 "Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim".

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët "ose ekuivalenti i tij/saj".